# TRIBUNA SINDIKALE

**Maj 2007**

Dhe drit' e diturisë
përpara do na shpjerë






Editorial

# TAKSA E SHESHTË TË MOS PREKË PAGËN E MËSUESVE

Diskutimi për taksën e sheshtë, që Qeveria ka parashikuar të zbatojë nga 1 korriku 2007, ka përfshirë edhe masën e mësuesve dhe sindikatat e arsimit si përfaqesuese të interesave të tyre.

Po c'perfaqëson taksa e sheshtë dhe c'pasoja sjell ajo në pagën e mësuesve?

Sipas variantit që ka përgatitur Ministria e Financave dhe që tashmë është shpallur edhe si objektivi i Qeverisë, paga e cdo punonjësi, përfshirë sektorët jobuxhetorë dhe buxhetorë, pra edhe punonjësit e arsimit parauniversitar , duke filluar nga 1 korriku i këtij viti do të tatohet me 10 përqind.

Kjo masë tatimi mbi pagat e ulta dhe relativisht te ulta, sic është sektori i arsimit parauniversitar, cënon në mënyrë shumë të ndjeshme pagën neto që marrin sot mësuesit. Për ta bërë më të qartë, po krahasojmë tatimin që paguan sot një mësues, mbi bazën e kuadrit ligjor ekzistues, me tatimin që ai do të paguaj pas 1 korrikut, kur do të zbatohet taksa e sheshtë prej 10 përqind. Bazë për krahasim janë marrë paga më e ulët, paga mesatare dhe paga më e lartë bruto që marrin sot mësuesit e këtij sistemi:

Paga më e ulët bruto në arsimin parauniversitar për mësuesin fillestar në shkollën 9 vjecare është 25.160 lek. Duke zbatuar tarifat që janë sot në fuqi, sipas të cilave pagat deri 14.000 leke tatohen 1 përqind, dmth 140 leke dhe difrenca nga 14 000 deri në 25160 = 11.160 me 5 përqind, që është baraz me 558 leke, msuesi që përfshihet në këtë grup paguan 698 leke. Mbas 1 korrikut, mësuesit me pagën më të ulët do të paguajnë 2 516 leke ose 1.818 leke më shumë se sa tatimi mbi pagën që paguan sot. Zbatimi i kësaj mase tatimore ul pagën neto të mësuesve me paga më të ulta në masën 8.4 përqind.

Paga mesatare në arsimin 9 vjecar dhe të mesëm sot është 30.171 leke. Mësuesit që përfshihen sot në këtë kategori paguajnë një tatim mbi pagën në masën 950 leke, ndërsa pas 1 korrikut do të paguajnë 3.017 leke ose 2.067 leke më shumë se sa tatohen sot.

Së fundi, mësuesit me pagë bruto maksimale që sot është 35.185 leke me legjislacionin në fuqi paguajnë një tatim prej 1.204 leke, ndërsa mbas 1 korrikut do të paguajë si tatim mbi pagen 3.518 leke ose 2.314 leke më shumë, në krahasim me tatimin që paguajnë sot.

Kjo masë e rritur e tatimit mbi pagë, ul pagën neto të mësuesve me pagë mesatare dhe maksimale rreth 7.6 përqind.

Në këto kushte, sindikatat e arsimit, FSASH dhe SPASH i kanë kërkuar Ministrisë Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Financave që aplikimi i taksës së sheshtë prej 10 përqind mbi pagën të mos prek nivelin e sotëm të pagës neto që merr cdo mësues.

Negocimet kanë filluar si me Ministrinë e Arsimit dhe me Ministrinë e Financave.

FSASH dhe SPASH janë në pritje të përfundimit të studimit që po bëhet për këtë cështje, duke qenë të vendosura që të mbrojnë pagën që marrin mësuesit sot dhe duke këmbëngulur që cdo rritje e masës së tatimit mbi pagën bruto të kompensohet me shtimin përkatës të pagës neto.

# PERMBAJTJA


- *Editorial:* Sindikatat mbi taksen e sheshte 2
- Projekti me FNV faktor i rendesishem per fuqizimin e FSASH e SPASH dhe eliminimin e punes se femijeve 3
- Konference e MASH per programin vjetor te reformes 8
- Angazhim i ri per rritjen e interesit per shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve 9
- Nga mbledhja e Kryesise se SPA Qarku Tirane 10
- Gjendja e Kontratave te punes dhe detyrat e sindikates per rritjen e cilesise se tyre 11
- Synimi yne, ruajtja dhe zhvillimi i traditave me te mira arsimore te popullit tone 12
- Eshte fjala për Mati Logorecin 13
- Te reja shkencore dhe keshilla praktike 15


**Kopertina e pare:**
*Konferenca Rajonale e FSASH/SPASH per eliminimin e punes se femijeve*
**Kopertina e fundit:**
*Pas nje aktiviteti edukativ*


**TRIBUNA SINDIKALE**
**Nr. 27, Periodike**
*Botim i FSASH dhe SPASH*

Me mbeshtetjen financiare te Konfederates se Sindikatave te Holandes, FNV

*ADRESA: Bulevardi "Zogu i Pare" Pallati Ali Kelmendi, kati III,*
*Tel: 22 83 46*
*Tel & Fax: 25 65 32*
*E-mail:fsash@icc-al.org*



**Keshilli Botues:**
Xhafer Dobrushi,
Bajram Kruja,
Lumturi Mataj,
Defrim Spahiu,
Petref Çelaj,
Aleks Dushi,
Stavri Liko, **Kryeredaktor**

# Projekti me FNV faktor i rendesishem per fuqizimin e FSASH e SPASH dhe eliminimin e punes se femijeve

Ne vijim te zbatimit rezultativ te Projekteve te Sindikates se Pergjitheshme te Arsimit te Holandes, AOb, me dy sindikatat shqiptare te arsimit, Federaten e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences te Shqiperise, FSASH, dhe Sindikaten e Pavarur te Arsimit Shqiptar, SPASH, mbeshtetur financiarisht, ne fillim nga organizata holandeze NOVIB, dhe me pas nga Konfederata e Sindikatave te Holandes, FNV, se bashku me AOb, nje Projekt i ri ndihme dhe mbeshtetjeje per fuqizimin e FSASH dhe SPASH fillon te zbatohet nga keto dy sindikata, nepermjet mbeshtetjes financiare te Konfederates Holandeze te Sindikatave, FNV, ne dy vitet ne vazhdim, 2007 – 2008.

Epiqendra e ketij Projekti eshte zgjerimi i angazhimit te FSASH e SPASH dhe te nje numri gjithnje e me te madh mesuesish, anetare te ketyre sindikatave, ne aktivitetet konkrete per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, duke e konsideruar arritjen e sukseseve ne kete fushe te lidhur ngushte, si deri me tani, me fuqizimin organizativ dhe rritjen e efektivitetit te veprimtarise se ketyre sindikatave.

Mbeshtetur ne arritjet e deritanishme, i konsideruar si nje faze e dyte e projektit te meparshem, Projekti aktual vazhdon te mbeshtese rinovimin dhe zhvillimet demokratike te FSASH e SPASH, duke u perqendruar sidomos ne konsolidimin e strukturave drejtuese te tyre, sidomos ne nivel lokal, forcimin e bashkepunimit midis tyre, rritjen e numrit te anetareve, vecanerisht nga grate mesuese dhe mesuesit e rinj, permiresimin e gjendjes financiare, nepermjet shtimit te numrit te anetareve qe paguajne kuotizacionin e anetaresise dhe rritjes progresive te mases se pageses sipas statuteve perkatese, si edhe rritjen e rolit dhe te ndikimit te sindikatave ne reformimin dhe modernizimin e procesit mesimor dhe zhvillimet ekonomiko – shoqerore ne vendin tone.

Kater jane shtyllat kryesore te ketij Projekti:

- Fuqizimi i FSASH dhe SPASH nepermjet rritjes se numrit te anetareve, shtimit te te ardhurave nga kuotizacioni, konsolidimit te strukturave lokale, rritjes se kapaciteteve dhe informimit te anetareve,

- Angazhim i vecante per problemet e grave mesuese, permiresimin e pozites se tyre ne arsim dhe rritjen e pjesemarrjes ne sindikate,

- Angazhimi i sindikatave per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve,

- Zgjerimi i komunikimit dhe ndergjegjsimi i mesuesve anetare te FSASH e SPASH.

Per secilen prej ketyre fushave jane parashikuar objektiva dhe tregues konkrete, aktivitete te perbashketa ne nivel qendror e lokal, si edhe angazhim i drejtuesve te sindikatave ne rrethe e shkolla dhe pjesemarrje masive e mesuesve, anetare te ketyre sindikatave, ne keto aktivitete.



1. Fuqizimi i FSASH dhe SPASH nepermjet rritjes se numrit te anetareve, shtimit te te ardhurave nga kuotizacioni, konsolidimit te strukturave lokale, rritjes se kapaciteteve dhe informimit te anetareve.

Fuqizimi i gjithanshem i FSASH e SPASH do te vazhdoje te jete nje nga objektivat me te rendesishme te ketij Projekti, duke synuar struktura te konsoliduara dhe efektive ne te gjitha rrethet, drejtues te trajnuar dhe te afte, jo vetem ne nivel rrethi, por edhe ne shkolla, veprime konkrete per rritjen e pjesemarrjes se grave e mesuesve te rinj ne jeten sindikale dhe permiresimin e ndjeshem te gjendjes financiare per mbeshtetjen e funksionimit te ketyre strukturave.

Nje nder drejtimet me te rendesishme ne kete fushe do te jete permiresimi i gjendjes financiare te te dy sindikatave, si parakusht per funksionimin normal dhe efektiv te strukturave te tyre.

Disa nga objektivat kryesore ne lidhje me kete ceshtje jane:

- rritja e numrit te anetareve qe paguajne kuoten e anetaresise me te pakten 4 500 anetare, prej te cileve 1 500 nga FSASH dhe 3 000 nga SPASH, me synimin qe te arrihet niveli i 10 000 anetareve per FSASH dhe 7 000 per SPASH, duke hequr dore nga koncepti "anetare me lista" dhe duke konsideruar anetare vetem ata qe paguajne kuoten e anetaresise.

- rritja e sasise se kuotes se anetaresise nga rreth 0.25 perqind te pages qe eshte aktualisht, ne nivelin 0.35 perqind per vitin 2007, ne nivelin 0.45 perqind per vitin 2008, me synimin qe ne perfundim te Projektit te arrihet niveli statutor prej 0.5 perqind.

Realizimi i ketyre objektivave, qe do te coje ne rritjen e ndjeshme te te ardhurave per te dy sindikatat, do te synohet te arrihet, krahas veprimtarise se perditeshme, edhe nepermjet organizimit te disa aktiviteteve ne kuadrin e ketij Projekti, te cilat synojne

Vijon në faqen 4

Vijon nga faqja 3
konsolidimin e strukturave lokale dhe sqarimin e organeve perkatese te pushtetit lokal ne lidhje me detyrimet ligjore qe ato kane ne marrdhenie me sindikatat.

Per kete qellim, drejtuesve te seksioneve sindikale ne rrethe u shtrohet detyra qe te pergatisin listat e anetaresise, sipas kerkesave te legjislacionit perkates, nderkohe qe kryesite qendrore do te pergatisin gjithe dokumentacionin perkates per cdo bashki e komune qe do t'u kerkohet kryerja e veprimeve financiare sipas Kodit te Punes dhe Kontrates Kolektive te Punes.

Ne vijim, do te organizohen takime te posacme, sidomos ne qarqet kryesore, ku do te zberthehet kuadri ligjor dhe do te behen sqarimet e nevojeshme ne lidhje me procedurat e kryerjes se veprimeve financiare per grumbullimin e kuotes se anetaresise, nepermjet borderose, ashtu sic veprohet ne te gjitha sindikatat e vendeve te perparuara.

E gjithe kjo pune do te shoqerohet me perpjekje konkrete per rritjen e numrit te anetareve, duke permiresuar edhe sherbimet ndaj tyre, duke u perqendruar sidomos tek shperblimet plus per pune mbi kohen normale dhe per rezultate me te mira.

Me kete synim, do te organizohen edhe dy Tryeza te rrumbullakta, me pjesemarrjen e specialisteve holandez te AOb, te cilet do te paraqesin pervojen e tyre ne lidhje me format dhe metodat qe ata perdorin per me shume sherbime ndaj anetareve.

Po me kete synim do te punohet edhe ne drejtim te konsolidimit te seksioneve sindikale ne rrethe, duke u perqendruar si ne ato seksione qe kane qene objekt i fazes se mepareshme te ketij projekti, ashtu edhe ne 10 seksionet te cilet nuk kane marre pjese ne aktivitetet e zhvilluara gjate viteve 2005-2006.

Disa nga objektivat qe synohen ne kete drejtim jane:

- riorganizimi dhe ristrukturimi i seksioneve sindikale ne 10 rrethet ku te dyja sindikatat nuk i kane ato te mire organizuara, (Bulqize, Delvine, Gramsh, Has, Lushnje, Malesi e Madhe, Peqin, Puke, Sarande, Tropoje),
- konsolidimi i metejshem i seksioneve ne 26 rrethet, ku eshte punuar tashme dhe funksionojne seksionet perkatese,
- puna e vecante me grupet e mesuesve te rinje ne keto seksione dhe ndermarrja e veprimeve konkrete per plotesimin e kerkesave te vecanta te tyre.

Per kete qellim, do te krijohet dhe funksionoje nje Grup Pune me perfaqesues nga te dyja sindikatat, icili do te merret drejtperdrejt me identifikimin e problemeve, perpunimin e planit te punes dhe organizimin e aktiviteteve dhe veprimeve konkrete per realizimin e objektivave ne kuadrin e Projektit.

Ne vijim, me perfaqesuesit e ketyre seksioneve, do te organizohet nje seminar treditor per kualifikimin e tyre, duke u perqendruar sidomos tek menyra e organizimit efektiv te sindikatave ne nivel shkolle, shtimi i numrit te anetareve, sidomos nga radhet e grave dhe mesuesve te rinje, rritja e rolit te mesuesve ne procesin e reformes ne arsim, zbatimi i kontrates kolektive dhe forcimi i bashkepunimit me drejtorite dhe zyrat arsimore etj.

Takimet qe do te organizohen me drejtuesit e ketyre seksioneve do te analizojne situaten dhe do te percaktojne drejtimet kryesore dhe aktivitetet ne vijim, do te perpunojne strategji te vecanta per konsolidimin e metejshem te ketyre seksioneve dhe bashkepunimin e tyre me seksionet e tjera me pervoje ne kete drejtim.

2 Angazhim i vecante per problemet e grave mesuese, permiresimin e pozites se tyre ne arsim dhe rritjen e pjesemarrjes ne sindikate

Rritja e numrit dhe rolit te grave ne sindikate vazhdon te mbetet nje objektiv i rendesishem i Projektit, ku synohen tregues konkrete.

Te dyja sindikatat do te punojne konkretisht ne seksionet e 10 rretheve qe kane mbetur nga faza e pare e Projektit, duke organizuar ngritjen dhe funksionimin e komiteteve te grave dhe strukturave perkatese, duke organizuar aktivitete te ndryshme, sidomos per kualifikimin e drejtueseve te ketyre komiteteve per t'i aftesuar ato qe te perpunojne dhe zbatojne politika sindikale efektive ne mbrojtje te grave mesuese, nderkohe qe do te vazhdoje puna per konsolidimin e metejshem te komisioneve te grave qe jane ngritur tashme ne 26 rrethet e tjera.

Nder objektivat kryesore ne kete fushe jane:

- ngritja dhe funksionimi i komiteteve te grave ne 10 rrethet qe akoma nuk i kane keto, (Bulqize, Delvine, Gramsh, Has, Lushnje, Malesi e Madhe, Peqin, Puke, Sarande, Tropoje), duke i ndihmuar ato te organizojne grate mesuese ne sindikate dhe te trajtojne problemet specifike te grave ne arsim,
- konsolidimi i komiteteve te grave qe jane ngritur tashme dhe funksionojne ne seksionet e konsoliduara, me te cilat eshte punuar konkretisht gjate fazes se pare te projektit, duke i ndihmuar ato te njohin me mire situaten dhe te perpunojne politika sindikale efektive per mbrojtjen e grave mesuese,
- rritja e perqindjes se pjesemarrjes se grave ne sindikae ne nivelin 52 perqind, ose

2. 7 perqind me shume, ne krahasim me gjendjen aktuale,

- rritja e perqindjes se grave mesuese ne organet drejtuese te sindikatave ne nivelin 32 perqind ose 7 perqind me shume, krahasuar me nivelin aktual,
- mbeshtetja e shanseve te barabarta per grate mesuese, sidomos ne lidhje me punesimin dhe karrieren ne sektorin e arsimit,
- permiresimi i kuadrit ligjor, duke propozuar dhe kerkuar permiresime ne lidhje me legjislacionin kombetar per grate ne tregun e punes,
- trajtimi i problemeve specifike te grave mesuese, dhe rritja e rolit te tyre si nena, sidomos ne marrdhenie me nxenesit qe kane me shume probleme ne vijim dhe ne pervetesimin e programeve mesimore, duke synuar shmangien e largimeve nga shkolla dhe eliminimin e punes se femijeve.

Per realizimin e ketyre objektivave, jane parashikuar nje sere aktivitetesh, duke filluar qe nga krijimi i nje Grupi pune ne nivel kombetar, i perbere nga 8 anetare, perfaqesuese te dy sindikatave, te Drejtorive Arsimore, administratave te shkollave dhe komunitetit.

Per te bere analizen e punes e te rezultateve dhe per te caktuar detyrat per periudhen ne vazhdim, jane parashikuar dy takime me drejtueset e grave gjate vitit 2007 dhe dy takime te tjera gjate vitit 2008, ku do te diskutohet ne lidhje me Projektin, gjendjen, objektivat, aktivitetet qe do organizohen, punen konkrete qe do te behet, si edhe do te behet nje bilanc i realizimit te objektivave dhe do te caktohen detyrat per periudhen ne vijim, me qellim qe te plotesohen dhe avancohen objektivat e Projektit dhe te permiresohen metodat e punes qe do te perdoren, duke siguruar nje bashkepunim te ngushte edhe me OJF te tjera qe merren me keto ceshtje.

Ne vazhdim, do te organizohet nje

seminar me pjesemarrjen e grave drejtuese te sindikatave ne nivel lokal, nga 10 seksionet sindikale ku do te organizohen komitetet e grave dhe do te funksionojne strukturat e vecanta per to, te cilat do te trajnohen e do te pergatiten per t'u aktivizuar konkretisht per realizimin e ketyre objektivave.

Tematika e ketij seminari do te kete te beje sidomos me analizen e situates aktuale, problemet qe ndeshen, angazhimin per kapercimin e tyre, objektivat qe duhet te arrihen, si edhe ceshtje qe kane te bejne me legjislacionin, statutet, rregulloret, politikat per punen me grate etj.

Prezenca e eksperteve holandeze ne kete seminar do te sherbeje per te njohur nga afer pervojen e AOb dhe per te diskutuar ne lidhje me mundesite e zbatimit te kesaj pervoje ne kushtet aktuale te sindikatave tona.

Pjese e rendesishme e Projektit ne lidhje me grate mesuese do te jete nje anketim dhe, me pas, nje Tryeze e rrumbullakte, te cilat do te merren sidomos me ceshtjet qe kane te bejne me:

- problemet me te cilat ndeshen grate mesuese ne tregun e punes dhe qendrimin e sindikkatave ndaj ketyre problemeve,

- sa i kane ngritur grate keto probleme ne sindikate dhe cili ka qene reagimi i sindikatave ne lidhje me keto probleme,

- situaten ne lidhje me komitetet e grave qe jane ngritur e funksionojne dhe cfare presin me shume grate mesuese nga keto komitete dhe strukturat e vecanta te sindikatave per punen me grate,

- problemet qe kane te bejne me rolin e sindikatave per organizimin e kohes se lire te grave mesuese, sidomos ne funksion te ndikimit per karrieren e tyre profesionale, per interesat kulturore, marredheniet sociale etj.

Konkluzionet e ketij anketimi do te disutohen ne nje Tryeze te rrumbullaket, me pjesemarrjen edhe te eksperteve holandeze, ku do te perpunohet edhe nje program konkret pune per rritjen e rolit te sindikatave ne keto drejtime.

Ne kete kuader, do t'i kushtohet kujdes edhe kualifikimit te metejshem te grave drejtuese ne komitetet e ngritura ne seksionet e konsoliduara, me te cilat do te organizohen, gjate periudhes dyvjecare, dy seminare, te cilat do te fokusohen sidomos ne keto drejtime:

- roli i komiteteve te grave per mbeshtetjen e perpjekjeve te grave mesuese per progres ne te gjitha drejtimet,

- kuadri ligjor mbi shanset e barabarta ne sektorin e arsimit, roli i vecante i sindikatave ne kete fushe,

- situata aktuale dhe mundesite ne lidhje me kualifikimin profesional te grave, me synim qe te aftesohen ato te bejne progres ne profesion dhe ne karriere,

kontratat kolektive ekzistuese dhe roli i sindikatave per t'i perdorur ato ne funksion te problemeve te grave,

- angazhimi i personave te rendesishem, bordeve, komiteteve te grave per mbrojtjen e te drejtave te grave, praktikat e mira ne kete drejtim,

- roli i vecante i grave per problemet qe kane te bejne me mbrojtjen e te drejtave te femijeve dhe eliminimin e punes se femijeve.

Me rendesi eshte percaktimi i qarte i detyrave per grupet qe do te veprojne ne nivel qendror e lokal; evidentimi i gjendjes ne lidhje me pjesemarrjen e grave ne sindikate, ne tere kompleksitetin e saj; percaktimi i objektivave konkrete per secilen prej tyre, duke marre si minimum ato qe jane percaktuar ne kuadrin e Projektit; marrja e te gjitha masave organizative dhe shfrytezimi i te gjitha aktiviteteve, takimeve, seminareve, mbledhjeve, analizave etj, si fillim per nje pune konkrete per realizimin e ketyre objektivave.

3. Angazhimi i sindikatave per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve

Zgjerimi i angazhimit te sindikatave dhe mesuesve anetare te tyre per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve perben boshtin dhe objektivat kryesore te ketij Projekti.

Te dhenat ne lidhje me kete ceshtje vazhdojne te jene shume shqetesuese. Rezultojne rreth 45 000 femije qe punojne ne shkalle vendi, rreth 9 000 femije jane te trafikuar, shumica e te cileve ne Greqi e Itali, nje pjese e mire e te cileve u perkasin familjeve Rome.

Mbi 70 perqind e femijeve te trafikuar jane nga ata qe e kane braktisur shkollen, ndersa pjesa tjeter prej 30 perqind nuk e kane ndjekur rregullisht ate. Me problem vazhdojne te mbeten rrethet e medha, midis te cileve Tirana, Durresi, Shkodra, Elbasani, Korça, Fieri etj, ku do te perqendrohet vemendja e sindikatave edhe gjate periudhes dyvjecare ne vijim, ku do te angazhohen rreth 650 mesues, sociologe, juriste, ekonomiste etj, pjesemarres aktive ne grupet e punes ne te gjitha nivelet, ne seminaret dhe aktivitetet e tjera jashte shkolles, qe do te organizohen ne kete kuader.

Disa nga objektivat kryesore qe synojme te arrijme gjate kesaj peiudhe jane:

- ulja e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen me 25 perqind ne Tirane, Durres e Korce, ku akoma jane respektivisht rreth 1 070, ne Tirane, 617, ne Durres dhe 316 nxenes ne Fier qe kane braktisur shkollen,

- ulja e metejshme, me 20 perqind, e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen ne




Vijon në faqen 6

Vijon nga faqja 5

rrethin e Fierit, ku akoma jane 308 nxenes qe kane braktisur shkollen,

- ulja e numrit te nxenesve qe kane braktisur shkollen ne nivel kombetar me 12 perqind

- ulja e numrit te nxenesve ne rrezik per te braktisur shkollen me 60 perqind ne rrethet e perzgjedhura per te punar konkretisht dhe me 20 perqind ne shkalle vendi,

- ulja e numrit te nxenesve qe punojne ne rrethet e perzgjedhura me 15 perqind dhe ne shkalle vendi me 8 perqind.

Per realizimin e ketyre objektivave jane parashikuar te organizohen nje numer i konsiderueshem aktivitetesh dhe veprimesh konkrete ne nivel kombetar, ne nivel rrethesh e ne shkolla.

Ndihma konkrete per te funksionuar efektivisht Grupi Kordinues ne nivel Kombetar do te jete objekt i vecante pune per kryesite qendrore te te dy sindikatave.

Funksionet e ketij Grupi kane te bejne me harmonizimin e aktiviteteve ne kuadin e Projektit, me synim qe te kete nje lidhje logjike midis tyre dhe ato te shoqerohen me rezultate konkrete, perpunimin e strategjise mbi rolin e mesuesve ne klase, si te merren me nxenesit problematike, si te angazhojme te gjithe mesuesit dhe vete nxenesit per te parandaluar braktisjen e shkolles, punen e femijeve dhe trafikimin e tyre, analiza dhe vleresimi i punes se bere ne faza te vecanta te Projektit dhe organizimi me i mire i aktiviteteve ne vijim, kordinimi i veprimeve me perfaqesuesit e qeverisjes vendore, organet e rendit publik lokal dhe komunitetin, me qellim qe te shmanget braktisja e shkolles dhe puna e femijeve.

Rezultati pritet qe te jete funksionimi i kater Grupeve te Punes ne rrethet e perzgjedhura (Tirane, Fier, Durres, Korçe) per te siguruar nje angazhim sa me te gjere te mesuesve per parandalimin e braktisjes se shkolles nga nxenesit dhe te punes se femijeve.

Keto grupe do te ndjekin nga afer punen qe do te behet per:

- identifikimin e gjendjes ne rrethet respektive ne lidhje me nxenesit qe kane braktisur shkollen ose qe jane ne rrezik per ta braktisur ate, si edhe ata qe punojne,

- percaktimin e veprimeve konkrete qe do te ndermerren ne shkalle rrethi dhe ne shkollat e perzgjedhura dhe organizimin e aktiviteteve te planifikuara, ne bashkepunim me sindikatat e degeve te tjera dhe partneret e tjere sociale,

- organizimin e aktiviteteve konkrete me nxenesit me probleme dhe prinderit e te afermit e tyre, duke bashkepunuar edhe me administraten e shkolles dhe perfaqesuesit e pushtetit vendor,

- ndergjegjesimin shoqeror ne shkolle e jashte saj mbi rrezikun e punes se femijeve per vete ata, si edhe per mbare shoqerine.

Vendimtar per realizimin e objektivave te Projektit do te jete ngritja dhe funksionimi i grupeve te punes ne shkollat pilot, (4 ne rrethin e Tiranes (Kamez e Re, Valias, Burqesh e Zallmner) dhe 4 ne rrethin e Fierit, (Levan, Mbrostar, Zhupan dhe Roskovec), si edhe ne shkollat qe do te perzgjidhen nga vete grupet e punes ne rrethet e Durresit e te Korces.

Secili prej ketyre Grupeve do te beje 2-3 takime ne vit, por kuptohet qe realizimi i detyrave ne nivel lokal do te kerkoje me shume pune konkrete me nxenesit me probleme, si edhe takime e aktivitete te tjera te ketyre grupeve, qe do te ndiqen nga dy Kryesite qendrore dhe seksionet e FSASH e SPASH ne keto rrethe.

Keto grupe jane berthamat qe do te grumbullojne rreth vetes mesuesit me aktive per te organizuar punen konkrete me nxenesit qe kane braktisur shkollen ose me ata qe jane perzgjedhur si ne rrezik per te braktisur shkollen, e cila konsiston sidomos ne:

- Identifikimin e situates ne shkollat respektive dhe organizimin e marrjes ne kujdestari te nxenesve qe kane braktisur shkollen ose qe jane ne rrezik peer ta braktisur ate, nga ana e mesuesve qe do te angazhohen drejtperdrejt me kete pune,

- Plotesimin e pyetesoreve me te gjitha te dhenat per secilin prej tyre,

- Bashkepunimin me mesuesit kujdestare per problemet qe lidhen me vijimin dhe mbarevajtjen ne mesime,

- Rakordimin e punes me qeverine e nxenesve dhe komitetin e prinderve, per t'u ardhur ne ndihme ketyre nxenesve, edhe me ndihmen e nxenesve me te mire ne klasat perkatese,

- Organizimin e punes konkrete me nxenesit qe kane braktisur shkollen ose qe jane ne rrezik per ta braktisur ate, ose me ata qe punojne, duke perfshire edhe prinderit dhe te afermit e tjere, ne rastet kur ka perpjekje per t'i shkeputur ata nga shkolla,

- Trajtimin e ketyre problemeve ne organet e pushtetit vendor, per te pare mundesine e ndonje ndihme me vende pune ose me ndonje ushqim, ne rastet ekstreme,

- Me rendesi te vecante eshte rakordimi i gjithe kesaj pune me Drejtorite e shkollave dhe Drejtorite ose Zyrat Arsimore.

Ne rrethet ku ne perqendrohemi per here te pare ne kuadrin e ketij Projekti, Durres e Korçe, do te vijojne te organizohen seminaret me pjesemarrjen e drejtuesve sindikale, anetare te dy sindikatave, perfaqesuesve te administratave te shkollave dhe pushtetit lokal.

Tematika e ketyre seminareve do te kete te beje me:

- Kuadri ligjor per parandalimin e punes se femijeve dhe trafikimit, si te njihet me mire ai dhe si te ndikohet ne permiresimin e tij

- Situata reale mbi punen e femijeve dhe trafikimin e femijeve ne Shqiperi dhe roli i sindikatave te arsimit, ne bashkepunim me strukturat qeveritare, ILO-IPEC, ne Shqiperi dhe OJQ shqiptare te interesuara per kete ceshtje, per parandalimin e punes se femijeve dhe trafikimin e femijeve.

- Shkaqet e punes se femijeve, persa i perket kerkeses dhe ofertes, pasojat e punes se femijeve per shoqerine dhe vete femijet,

- Kordinimi dhe bashkepunimi me administratat e shkollave, organet e qeverisjes vendore, prinderit dhe komunitetin per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve,

- Puna e vecante e mesuesve me nxenesit me probleme, (ata qe nuk kane rezultate te mira, qe rrezikojne te braktisin shkollen, ata qe kane probleme me prinderit qe mund te jene te denuar, ose qe jane me nje ose pa prinder fare, si edhe femijet Rome), duke u marre konkretisht me rastet ne rrethet perkatese.

Efektive pritet te jene dy seminaret e planifikuara per t'u organizuar ne baze shkolle, me pjesemarrjen e disa mesuesve nga tete shkollat pilot, perfaqesuesve te administratve te shkollave, nxenesve dhe OJF-ve te angazhuara ne keto shkolla.

Tematika e ketyre seminareve do te fokusohet sidomos ne:

- situaten aktuale ne keto shkolla ne lidhje me braktisjen e shkolles dhe nxenesit ne rrezik per ta braktisur ate,

- roli i mesuesve dhe perfaqesuesve

te organizmave te tjera pjesemarrese per integrimin e ketyre nxenesve ne shkolle, metodat efektive qe mund te perdoren ne punen konkrete individuale me keta nxenes,

- kuadri ligjor per mbrojtjen e femijeve dhe parandalimin e punes se femijeve,

- situata ne lidhje me punen e femijeve, shkaqet dhe mundesia e nderhyrjes per permiresimin e gjendjes ne familjet perkatese,

- kordinimi dhe bashkepunimi me administratat e shkollave dhe OJF-te per parandalimin e largimeve nga shkolla dhe eliminimin e punes se femijeve,

- puna e diferencuar e mesuesve me nxenesit qe kane probleme, duke perfshire edhe ata nxenes qe jane me nje prind ose pa prinder, nxenesit e komunitetit Rome etj,

Dy seminare te tjere jane planifikuar te organizohen ne rrethet e perzgjedhura, (Tirane, Fier, Durres, Korçe), me pjesemarrjen e drejtuesve lokale te sindikatave, perfaqesuesve te prinderve e nxenesve dhe pushtetit lokale, ku do te vihet theksi sidomos ne njohjen e te drejtave te femijeve, sipas Konventes perkatese te Kombeve te Bashkuara, ne rendesine e arsimimit te te gjithe femijeve, si garanci per te ardhmen e tyre dhe te shoqerise sone, roli i prinderve dhe vete nxenesve per shmangien e largimeve nga shkolla dhe punes se femijeve, sigurimi i nje bashkepunimi efektiv midis perfaqesuesve te shkolles, prinderve e nxenesve dhe organeve te pushtetit lokal per permiresimin e gjendjes ne keto rrethe.

Pjesemarrja e specialisteve holandeze ne shumicen e ketyre seminareve do te jete nje kontribut i rendesishem, sidomos per njohjen e pervojave dhe praktikave te mira, ne lidhje me metodat efektive te punes dhe perpunimin e planeve per veprime konkrete ne te ardhmen.

Te gjitha konkuzionet qe do te dalin nga keto seminare, si edhe nga grupet e punes dhe nga veprimet konkrete te mesuesve me nxensit, do te behen objekt diskutimi ne nje Tryeze te rrumbullaket, ku do te analizohet puna e bere dhe situata, por, ne te njejten kohe, do te perpunohet edhe nje plan veprimi per te ardhmen, jo vetem per rrethet e perzgjedhura, por edhe me gjere.

Nje angazhim te vecante do te kene FSASH e SPASH ne kuadrin e ketij Projekti edhe per perfshirjen e disa sindikatave te degeve te tjera nga te dyja konfederatat, KSSH e BSPSH, (sidomos nga Tekstil-Artizanati, Bujqesia, Ndertimi, Industria e Lehte, Tregtia, etj), per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve

Per kete qellim do te organizohet nje seminar njeditor ku do te vleresohet situata, ne zbatim edhe te detyrave qe jane lene nga seminaret qe jane organizuar ne bashkepunim me ILO-IPEC dhe Konferenca Kombetare qe eshte organizuar ne bashkepunim me Konfederaten Nderkombetare te Sindikatave, ITUC, dhe do te perpunohet nje plan veprimi per bashkepunimin midis ketyre sindikatave, duke siguruar edhe mbeshtetjen e ILO-IPEC ne Tirane.

Ne vijim, me kete objekt, do te organizohen edhe nje Tryeze dhe nje Konference dy ditore nga fillimi i vitit 2009, ku do te behet nje bilanc dhe do te percaktohen drejtimet kryesore te punes se ketyre sindikatave ne vazhdim.

Specialiste te FNV do te marrin pjese dhe do te kontribuojne me eksperiencen dhe sugjerimet e tyre ne lidhje me permiresimin e punes dhe zgjerimin e perfshirjes se sindikatave qe do te angazhohen ne kete pune.

Me shume rendesi per arritjen e rezultateve te parashikuara ne punen per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve eshte percaktimi i qarte i detyrave per grupet qe do te veprojne ne nivel qendror, lokal dhe shkollash; evidentimi i gjendjes ne lidhje me nxenesit me probleme, nxenesit qe kane braktisur shkollen ose qe jane ne rrezik per ta braktisur ate, femijet qe punojne dhe qe jane ne rrezik per t'u trafikuar; percaktimi i objektivave konkrete per secilen prej tyre, duke marre si minimum ato qe jane percaktuar ne aplikimin per Projektin dhe marrja e te gjitha masave organizative per rritjen e efektivitetit te cdo aktiviteti.

4 Zgjerimi i komunikimit dhe ndergjegjesimi i mesuesve anetare te FSASH e SPASH

Fuqizimi i sindikatave dhe realizimi i objektivave te caktuara per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, ne kuadrin e ketij Projekti, jane te lidhura drejtperdrejt me zgjerimin e komunikimit me anetaret dhe me opinionin publik ne pergjithesi, per ndergjegjsimin e tyre dhe zgjerimin e angazhimit ne veprime konkrete.

Me shume se 650 mesues e specialiste, anetare te FSASH e SPASH, dhe 5 300 nxenes, qe do te perfshihen drejtperdrejt ne aktivitetet e shumta qe jane parashikuar te organizohen ne kuadrin e ketij Projekti, do te jene ne komunikim te vazhdueshem, jo vetem me mesues e perfaqesues te organizmave te tjera ne shkolle e ne komunitet, por edhe me strukturat qendrore e lokale te te dy sindikatave.

Nje rol te rendesishem do te luaj ne kete drejtim botimi rregullisht, tashme nje here ne dy muaj e me shpesh, i Revistes "Tribuna Sindikale", e cila do te kete nje ndikim te drejtperdrejte per perhapjen e informacionit ne lidhje me aktivitetet e zhvilluara ne kuadrin e Projektit e me gjere, per modernizimin dhe demokratizimin e sistemit arsimor, per perpunimin e opinionit te mesuesve e specialisteve, ne lidhje me ceshtjet e reformes arsimore, si edhe per mbrojtjen social ekonomike te anetareve te dy sindikatave.

Pervec drejtuesve te sindikatave ne nivel qendror e lokal dhe mesuesve te profileve te ndryshme, ne Reviste do te jene te pranishem edhe specialiste te institucioneve te ndryshme arsimore, te cilet pritet te japin nje kontribut te rendesishem per perpunimin e opinionit shkencor dhe trajtimin e problemeve qe lidhen me reformen ne arsim dhe modernizimin e arsimit ne vendin tone.

Krahas kesaj, me mbeshtetjen e ketij Projekti, me kontributin e dy sindikatave te tona te arsimit dhe ne bashkepunim me Ministrine e Arsimit e Shkences dhe Drejtorite Arsimore, do te behet e mundur qe ne 8 qarqe te vihen ne dispozion te seksioneve sindikale zyra te perbashketa, te cilat do te pajisen me mjete komunikimi, perfshire kompjuter, linje telefonike, e-mail dhe internet.

Do te perdoren, gjithashtu, edhe format e tjera te komunikimit, si broshura, postera, programe televizive, emisone radiofonike etj.

Organet drejtuese te dy sindikatave tona te arsimit, u jane shume mirenjohese Konfederates Holandeze te Sindikatave, FNV, dhe Sindikates se Pergjitheshme te Arsimit te Holandes, AOb, per mbeshtetjen financiare dhe ndihmen teknike qe po u japin FSASH e SPASH per realizimin e ketyre aktiviteteve, per fuqizimin e gjithanshem te tyre dhe per angazhimin e nje numri gjithnje e me te madh mesuesish per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.

Stavri LIKO
Kordinator i Projektit

# Cilesi dhe barazi ne arsim

## KONFERENCE PER PROGRAMIN VJETOR TE REFORMES

Ministria e Arsimit dhe Shkences organizoi me 25-26 tetor Konferencen per programin vjetor te reformes " Cilesi dhe Barazi ne Arsim". Projekti eshte pergatitur nga Qeveria

Shqiptare, ne bashkepunim me Banken Boterore, dhe do te ndihmoje ne zbatimin e Strategjise Kombetare te Arsimit.

Objektivi kryesor i Projektit eshte te permiresoje cilesine e kushteve te te nxenit per te gjithe nxenesit dhe studentet, te rrise frekuentimin ne arsimin e mesem te pergjithshem,

ne vecanti per te varferit, si dhe te garantoje vijueshmerine e reformave te koheve te fundit ne sektorin e arsimit.

Ne projektin " Cilesi dhe Barazi ne Arsim" po perdoret per here te pare nje qasje mbaresektoriale ne Shqiperi. Strategjia Kombetare e Arsimit perben bazen e ketij Projekti

e kesaj qasjeje dhe Qeveria do te organizoje takime gjashtemujore ne maj dhe tetor te cdo viti, (ne kuadrin e te cilit eshte organizuar edhe ky takim), per te paraqitur Programin e Reformes Vjetore dhe per te rishikuar ecurine e tij.

Parashikohet qe kjo qasje mbaresektoriale te forcoje pronesine e programit te reformave

nga ana e Qeverise, te lehtesoje bashkepunimin dhe koordinimin midis partnereve te zhvillimit dhe te forcoje kapacitetin menaxherial te sistemit arsimor.

Fushat prioritare te Projektit jane: fuqizimi i lidershipit, menaxhimi dhe qeverisja e sistemit arsimor, permiresimi i kushteve te mesimdhenies dhe te nxenit, permiresimi dhe racionalizimi i infrastruktures arsimore dhe pergatitja e terrenit per reformen ne arsimin e larte.

Ministri i Arsimit dhe Shkences, z. Genc Pollo beri prezantimin e pergjithshem te Projektit, duke u fokusuar ne objektivat dhe prioritetet.

Sic theksoi Ministri, prioriteti i pare lidhet me forcimin e lidershipit dhe kapaciteteve menaxhuese si dhe forcimi i qeverisjes dhe pergjegjshmerise se sistemit arsimor, qe do te thote:

- Zbatim i kujdesshem i decentralizimit, qartesimi i ndarjes se pergjegjsive, funksioneve dhe detyrave midis dhe ndermjet niveleve te sistemit arsimor.
- Futja e sistemeve te menaxhimit te bazuar ne performance.
- Caktimi i roleve te reja per drejtoret e shkollave.
- Rritja e vendim-marrjes dhe menaxhimit te burimeve ne nivel shkolle,
- Rritja e pjesemarrjes se komunitetit.
- Shfrytezim i plote i Sistemit te Informacionit te Menaxhimit te Arsimit (EMIS) ne sherbim te vendimarrjes.

Prioriteti i dyte, synon permiresimin e mesimdhenies dhe nxenies, si nje nevoje per nje rishikim te pergjithshem dhe permiresime rrenjesore. Konkretisht:

- Reforma kurrikulare,
- Hartimi i nje programi sistematik dhe afatgjate per kualifikimin profesional te mesuesve dhe drejtoreve te shkollave,
- Reforme ne vleresimin e nxenesve,
- Forcimi i kapaciteteve te MASH, te Qendres Kombetare Arsimore te Vleresimit dhe Provimeve, Institutit te Kurrikules dhe Standarteve, Qendres se Trajnimit dhe Kualifikimit per Arsimin dhe Drejtorive Arsimore.

Prioriteti i trete, ka si objektiv permiresimin dhe racionalizimin e infrastruktures arsimore, vecanerisht ne arsimin e mesem. Ky prioritet perfshine:

- Investime me efektive dhe (ri)alokim ne infrastrukturen fizike dhe ne burimet njerezore,
- Marrja e vendimeve ne fushen e investimeve bazuar ne hartat shkollore, duke marre parasysh levizjet demografike dhe migracionin,
- Laboratore shkencore dhe laboratore te informatikes per shkollat e mesme te pergjithshme, (qe do te shoqerohet edhe me trajnim te mesuesve).

Prioriteti i katert lidhet me pergatitjen e terrenit per reformen ne arsimin e larte, duke synuar vecanrisht:

- Modernizimin e struktures dhe kurrikules,
- Forcimin e strukturave qeverisese te universiteteve,
- Forcimin e mekanizmit te sigurimit te cilesise dhe akreditimit,
- Permiresimin e legjislacionit dhe formules se financimit,
- Rritjen e autonomise financiare dhe pergjegjshmerise se universiteteve,
- Mobilizimin e financimit privat,
- Permiresimin e efektivitetit te financimit publik,
- Vendosjen e urave lidhese midis kerkimit shkencor dhe mesimdhenies,
- Lidhjen me te qendrueshme me tregun e punes.

Per secilin prioritet u mbajten referate te vecanta ne diten e dyte te zhvillimit te Konferences dhe u bene diskutime ne grupet perkatese.

Z. Xhafer Dobrushi, kryetar i FSASH dhe z. Bajram Kruja, kryetar i SPASH, qe muaren pjese ne Konferencen plenare dhe ne punimet e grupeve te vecanta, theksuan rolin dhe angazhimin e sindikatave te arsimit, si partnere sociale, ne procesin e reformimit dhe modernizimit te arsimit. Drejtuesit e sindikatave kerkuan nga DAR dhe ZA qe te njihen me mire me Kontraten Kolektive te Punes, ne te cilen jane sanksionuar shume elemente te ketij procesi reformimi dhe te punohet me korrektesi nga te dy palet per t'i zbatuar ato.

Pas relatimit te konkluzioneve qe paraqiti cdo grup, per secilin prioritet, ne seancen plenare, Ministri i Arsimit dhe Shkences z. Genc Pollo theksoi angazhimin e MASH dhe te strukturave te saj per realizimin e objektivave te Projektit " Cilesi dhe Barazi ne Arsim".

Korresp. i " Tribuna Sindikale"

# Angazhim i ri per rritjen e interesit per shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve

Ne vijim te aktiviteteve per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, me mbeshtetjen e Federates Nderkombetare te Arsimit, EI, nepermjet Fondacionit Holandez NOT, Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, FSASH, dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar, SPASH, kane ndermarre nje angazhim konkret per te punuar me nxenesit qe kane braktisur shkollen ose jane ne rrezik per ta braktisur ate, ne 6 shkolla te rretheve Tirane, Elbasan dhe Korce.

Ne kete kuader FSASH e SPASH, jane perqendruar ne dy shkollat 9- vjecare te Bathores, ne Tirane, ne dy shkollat ku ka me shume nxenes nga komuniteti Rome, "De Rada" dhe "P. Xhuvani", ne Elbasan dhe ne dy shkolla ku mbizoteron komuniteti maqedonas, ne Liqenas te Qarkut te Korces, ku jane planifikuar qe te organizohen gjate ketij viti, periudha prill-nentor, disa veprimtari qe lidhen me parandalimin e largimeve nga shkolla, eliminimin e punes se femijeve dhe rritjen e interesit per shkollen nga ana e nxenesve qe kane pervetesim te ulet te lendeve mesimore.

Perqendrimi ne keto shkolla eshte bere per aresyet specifike qe kane te bejne me objektin e ketij programi.

Ne zonen e Bathores, ku ne te dy shkollat 9-vjecare frekuentojne rreth 2 750 nxenes, krahas problemeve te tjera, ekziston edhe largimi i disa vajzave nga shkolla per shkak te mentalitetit konservator te prinderve, te cilet e konsiderojne te rrezikshem vazhdimin e shkolles, ne klasat e larta te shkolles 9-vjecare, kur ato jane te rritura fizikisht. Ne kete zone jane perzgjedhur 50 nxenese, me te cilat synohet te punohet konkretisht, per te menjanuar rrezikun e braktisjes se shkolles, si edhe kthimin ne shkolle, ne rastet e largimeve prej saj gjate ketyre 2-3 vjeteve te fundit.

Ne Elbasan, jane perzgjedhur dy shkollat, "De Rada" dhe "P. Xhuvani", ku vijone rreth

1 250 nxenes, nje pjese e mire e te cileve nga komuniteti rome, te cilet perballen me shume veshtiresi qe kane te bejne, jo vetem me probleme ekonomike te familjeve te tyre, por edhe me qendrime te diferencuara, jo rralle edhe diskriminuese. Ne keto shkolla jane perzgjedhur 40 nxenes Rome, me te cilet synohet te punohet konkretisht per t'i ndihmuar ata qe te integrohen sa me mire ne klasat dhe shkollat perkatese dhe ne shoqeri.

Ne Korce, jane perzgjedhur dy shkollat e komunitetit maqedonas ne zonen e Liqenasit, ku vijojne rreth 340 nxenes, ku jane perzgjedhur 40 nxenes, te cilet kane veshtiresi te vijojne rregullisht dhe sidomos te kene rezultate te larta ne mesime, vecanerisht per shkak te situates ekonomike e financiare te familjeve te tyre, gje qe synohet te kombinohet me plotesimin e disa kerkesave qe mesues e nxenes te ketij komuniteti kane per tekstet ne gjuhen amtare, programet mesimore etj.

Ne kuadrin e ketij programi synohet qe me te 130 nxenesit qe jane perzgjedhur si ne rrezik per ta braktisur shkollen ose qe kane probleme me pervetesimin e programeve mesimore, ka filluar te behet nje pune konkrete per t'i nxjerre ata nga kjo gjendje dhe per t'i vene ne rrugen e integrimit te plote ne klasat dhe shkollat perkatese.

Per kete qellim jane pergatitur e shperndare disa pyetesore te cilet po plotesohen me kujdes, ne bashkepunim me nxenesit respektive, duke e vene theksin tek arsyet e kesaj gjendjeje dhe masat qe mund te merren per permiresimin e situates.

E tere kjo pune do te kombinohet me rritjen e ndergjegjshmerise per domosdoshmerine e arsimimit per te gjithe, si edhe me rritjen e rolit te mesuesve per uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe angazhohen ne pune.

Per realizimin e ketyre objektivave ne kuadrin e ketij programi, jane ne funksionim Komiteti i Monitorimit te Punes se Femijeve, qe funksionon ne nivel qendror, dhe tre grupe pune ne shkollat perkatese, te cilet po ndjekin nga afer te gjitha aktivitetet qe po organizohen ne kete kuader.

Ne Takimin e pare qe organizoi ky Komitet, ku pervec perfaqesuesve te FSASH e SPASH, moren pjese edhe perfaqesuesi i Ministrise se Arsimit dhe Shkences, Z. Fatmir Bezati dhe perfaqesues te Drejtorive Arsimore te rretheve Elbasan e Korce, u percaktuan detyrat per organizimin e aktiviteteve sipas programit dhe per marrjen e te gjitha masave qe te realizohen sa me mire objektivat e ketij programi.



Zoti Fatmir Bezati siguroi per mbeshtetjen e MASH dhe per angazhimin e tij ne aktivitetet e ketij programi, qe u vleresua si i domosdoshem per te ndihmuar nga afer shkollat e perzgjedhura.

Ne vijim te kesaj mbledhjeje dhe sipas detyrave dhe afateve qe u percaktuan ne programin e punes, u zhvilluan mbledhjet

Vijon në faqen 9

Vijon nga faqja 8

e grupeve te punes ne shkollat perkatese, si edhe diskutimi ne keto shkolla me pjesemarrjen e mesuesve te angazhuar ne punen konkrete me nxenesit e perzgjedhur.

Diskutimet ishin specifike per shkollat e cdo rrethi. Ne Elbasan vemendja u perqendrua tek nxenesit e komunitetit Rome, ku u vu theksi tek puna e vecante me ta, por edhe me familjet e tyre, si edhe tek mundesia e sigurimit te ndonje ndihme ekonomike, qofte edhe modeste. Ne Liqenas te Korces, diskutimi ishte edhe me interesant dhe kishte te bente me kerkesat e nxenesve te komunitetit maqedonas, ndersa ne dy shkollat e Bathores ne Tirane objekt diskutimi ishte puna me vajzat qe rrezikojne te braktisin shkollen per shkak te mentalietit konservator te prinderve.

Diskutimet ne grupe ishin shume konkrete dhe konkluduan me hartimin e planeve te punes per cdo shkolle, ndersa ne takimet konultative mesuesit shprehen mendimet e tyre ne lidhje me menyren e organizimit te punes, metodat qe duhet te perdoren ne klasa, ne shkolla dhe jasht tyre ne komunitet dhe ne familje.

Pas diskutimeve konkrete, u ra dakord qe, ne baze te listes se pergatitur nga grupet e punes, mesuesit e angazhuar te punojne konkretisht me nxenesit perkates, duke filluar nga plotesimi i pyetesorit dhe percaktimi i metodave efektive, deri tek kontaktet me te afermit e familjare te nxenesve.

Te dy kryetaret e sindikatave Z. Xhafer Dobrushi e Z. Bajram Kruja moren pjese ne te gjitha takimet dhe dhane kontributin e tyre me sqarime e angazhime per nje pune rezultative ne interes te ketyre nxenesve e mesuesve te angazhuar ne kuadrin e ketij programi.

Aktiviteti ne vijim do te jete nje diskutim popullor qe do te organizohet nga fundi i majit dhe fillimi i qershorit ne gjashte shkollat e perzgjedhura, me pjsemarrjen e te gjithe nxenesve dhe mesuesve te angazhuar ne kete program

Aktivitetet kulturore-sportive, ne formen e garave ne baze shkolle, nje Tryeze e rrumbullakte qe do te zhillohet me pjesemarjen e mesuesve e nxenesve te angazhuar ne keto aktivitete, disa emisione televizive ne rrethet perkatese, aktivitete keto qe do te organizohen ne vjeshte, do te synojne nje pune konkrete per integrimin me te mire te ketyre nxenesve ne jeten e klasave dhe shkollave perkatese, propagandimin e domosdoshmerise per arsimim cilesor per cdo femije, si edhe nxjerrjen e disa konluzioneve per vazhdimin e metejshem te kesaj pune ne keto shkolla dhe zgjerimin e mundshem te saj edhe ne shkolla te tjera.

# NGA MBLEDHJA E KRYESISE SE SPA TE QARKUT TIRANE

Kryesia e Sindikates se Pavarur te Arsimit te Qarkut Tirane ne mbledhjen e saj analizoi punen e bere deri tani dhe detyrat per te ardhmen, kryesisht per nje bashkrendim te punes midis punuar ne menyre individuale me anetaret e sindikates, por mbetet akoma pune per te bere nga kryetaret e shkollave, sidomos ne organizimin e brendshem, si edhe puna me kryesine e shkolles.



organeve te zgjedhura dhe anetareve te thjeshte te sindikates, per nje pune me konkrete ne njohjen e detyrave nga çdo sindikalist dhe menyren e kordinimit te punes me organet e qeverisjes vendore.

Nga analiza doli se anetaret e Kryesise kane qene te mobilizuar per te kryer detyrat ne komunat qe mbulojne. Eshte

Pamjaftueshmeria e kesaj pune ka sjelle dhe mangesite e funksionimit te nje parteneriteti me te mire me drejtuesit e shkollave. Ne mjaft shkolla te Qarkut drejtuesit e sindikates nuk i bejne present para drejtorise se shkolles problemet qe ato kane. Keshtu nga partneriteti i dobet dhe moszbatimi sa duhet i Kontrates Kolektive, nuk njihen sindikatat me buxhetin e caktuar per arsimin ne komune e bashki.

E njejta gje ndodh dhe me drejtuesit e shkollave, ku nga bisedat me to rezulton se dhe ato nuk njihen me keto fonde, por mjaftohen me disa kancelari e baze materiale pastrimi qe u japin magazinieret e ketyre njesive vendore. Nga diskutimet doli se duhet te punojme me shume per t'i sqaruar dhe per te shtuar numrin e antarve, sidomos ne komunat Peze, Preze, Vaqar, Vore, Paskuqan etj.

U theksua, gjithashtu, se synimi yne eshte qe cdo antare qe firmos ne listen e antaresise, te sqarohet per te drejtat dhe detyrimet qe ka ndaj sherbimit qe i kryen sindikata, si dhe detyrimit statutor per nje kontribut qe per kete periudhe e kemi caktuar me 50 leke ne muaj. Detyre ne te ardhmen mbetet qe te bindim nepunesit e administrates qe ky kuotizacion te mbahet ne llogarite e komunave e bashkive.

Per nje prezantim me serioz per perfaqesuesit tane, eshte mire qe ata te paisen ne karta identiteti.

Mbledhjen e pershendeti dhe kryetari i SPASH z Bajram Kruja, i cili vleresoi punen e bere nga Kryesia dhe beri sqarimet e nevojshme te disa pyetjeve ne lidhje me Statutin.

Shaban Duka
Kryetar i SPA te Qarkut Tirane

# Gjendja e Kontratave te punes dhe detyrat e sindikates per rritjen e cilesise se tyre

Ne Kongresin e pare te SPASH, qe u mbajt me 12-14 mars 1994, ndermjet objektivave paresore, ishte edhe pergatitja e sindikates si institucion per te negocuar dhe lidhur Kontraten Kolektive te Punes.

Per rendesine e lidhjes se Kontrates Kolektive, besoj se te gjithe jane te nder gjegjesuar, por me duhet te theksoj se nuk ka qene e lehte te arrihet deri ne kete nivel ku jemi sot.

Kontrata e pare Kolektive u nenshkrua me 8 shtator te vitit 1994. Kjo ishte nje ngjarje e rendesishme per SPASH, sepse per here te pare mesuesit shqiptare kishin nje Kontrate qe mbronte interesat e tyre dhe zhvillimin e arsimit kombetar.

Kontrata e dyte u firmos me 25 mars 1996. Si element te ri ne kete kontrate u vendos indeksimi i inflacionit dhe percaktimi i disa kritereve ne lidhje me reformen arsimore.

Ne vitin 1997, si rezultat i perpjekjeve te dyaneshme midis perfaqesuesve te SPASH e FSASH, u arrit te kaperceheshin shume pengesa dhe u nenshkrua Marreveshja e pare e bashkepunimit midis dy sindikatave shqiptare te arsimit. Kjo u pasua me organizimin e nje seminari te perbashket, ku mernin pjese keshillat kombetare te te dy sindikatave dhe ekspertet e tyre ne fushen e marredhenieve te punes. Mbas debateve konstruktive dy ditore, ku u diskutuan te gjithe kapitujt e projekt Kontrates Kolektive, u arrit qe perfaqesuesit qe do te paraqiteshin si pale punemarresish ne MASH te flisnin per here te pare me nje ze. Keshtu fillo te zbatohej demokracia sindikale.

Ne kete menyre u be e mundur qe me 8 janar 1998 te nenshkruhej me Ministrine e Arsimit dhe Shkences Kontrata e trete kolektive.

E veçanta e kesaj Kontrate ishte se, ne emer te mesuesve, nenshkruan sy sindikatat SPASH- FSASH. Kjo kontrate mund te themi se institucionalizoi bashkeveprimin sindikalist.

Te gjitha Kontratat Kolektive qe jane negocuar e nenshkruar me vone dhe konkretisht ne vitin 2000, 2002 dhe 2006 jane rezultat i bashkepunimit midis dy sindikatave tona te arsimit.

Le te vijme tani tek Kontrata Kolektive qe u nenshkrua me 4 korrik 2006 dhe qe do te jete ne fuqi deri me 31 dhjetor 2009.

Ne proçesin e negocimit me punedhenesin te dy sindikatat nenshkruese provuan edhe nje here identitetin e tyre, perfshi depozitimin e vendimeve ne Gjykaten e Tiranes, statutet perkatese, numerin e anetareve me lista e kuotizacion si dhe mareveshjen qe kane dy sindikatat per t'u paraqitur si pale e vetme perpara punedhenesit per negocimin e nenshkrimin e Kontrates Kolektive te Punes.

Ne baze te ketyre dokumentave te paraqitura SPASH – FSASH, u rikonfirmuan nga punedhenesi si partnere te vetem ne rolin e punemarresit per te gjithe sistemet e te KK te nivelit te pare.

Ne nenin 4/7-4/8, te cilet kane te bejne me punesikin, pershkruhen kushtet per zgjidhjen e maredhenieve te punes nga punedhenesi pa shkaqe te arsyeshme, kushte qe jane te mbeshtetura ne Kodin e Punes, konkretisht ne nenin 146, pika 1- shkronjat a, b, c, d. Ne praktike vrehen raste qe keto dispozita te KKP dhe te Kodit te Punes jane shkelur nga DAR dhe ZA, prandaj Seksionet dhe Keshillat Sindikale duhet te kembengulin per mbrojtjen e sindikalisteve dhe korigjimin e padrejtesive te vrejtura. Eshte per t'u pergezuar kryetari i Seksionit Sindikal te Qarkut Diber, i cili i ka zgjidhur shqetsimet e sindikalisteve deri



te punesuarve ne MASH.

Duhet t'u behet e ditur drejtuesve kryesore te sindikatave ne rrethe se kane te drejten per te lidhur kontraten kolektive me DAR dhe ZA, se kontrata e nivelit pare eshte baza kryesore per te nenshkruar kontraten e nivelit te dyte, e cila duhet te permbaje kontraktimin dhe detyrimet dypaleshe ne kushtet konkrete te qarkut ose te rrethit.

Me rendesi te vecante per kontratat e nivelit te dyte jane marredheniet qe krijohen midis seksioneve sindikale, DAR e ZA dhe pushtetit vendor, pa perjashtuar ketu edhe funksionimin e sindikatave dhe te keshillit sindikal ne shkolle.

Por, per te patur me te qarte konkretizimin e kontratave ne nivel te dyte, eshte e domosdoshme te ndalemi ne disa dispozita edhe me vendim gjykate. Gjykata ka mbrojtur te drejtat e mesuesve sindikaliste, duke u mbeshtetur te Kontrata Kolektive e nivelit te pare. Mund te kete edhe raste te tjera te cilat jane zgjidhur ne mirekuptim midis paleve.

Probleme jane vene re edhe ne zbatimin e Nenit 5 i cili ben fjale per ndryshimin e vendit te punes. Sindikatat mbeshtesin ndryshimin e vendit te punes, kur kerkesa per kete ndryshim vjen nga punemarresi, dmth, nga mesuesi dhe synon permiresimin e pozites se tij, ndersa ndryshimi i vendit te punes me inisiativen e punedhenesit behet vetem si perjashtim dhe ne kushte qe jane te caktuara ne menyre taksative ne kontrate. Ne cdo rast punedhenesi duhet te shprehet

Vijon në faqen 11

me shkrim 30 dite para fillimit te vitit shkollor per ndryshimin e vendit te punes te nje mesuesi. Nga te dhenat qe kemi, kjo nuk zbatohet nga punedhenesi. Pse ndodh kjo? A duhet te pajtohemi me kete gjendje, kur mesuesit transferohen pa kriter dhe atyre nuk u jepet as urdheri i transferimit?

Ne nenin 5/5 te KKP percaktohet qarte se urdheri per ndryshimin e vendit te punes duhet t'i jepet te punesuarit me shkrim dhe i motivuar, 30 dite para ekzekutimit, dhe vashdon me tej, brenda 30 diteve nga njoftimi palet bejne konsultime midis tyre dhe ne rast mos zgjidhjeje ato i drejtohen Zyres se Pajtimit, e pastaj edhe Gjykates.

Sindikatat duhet te qendrojne fort per t'u prere rrugen transferimeve gjate vitit mesimor, te cilat, pervec rasteve perjashtimore, jane te ndaluara.

Neni 7 i kushtohet kohes se pushimit. Ne kete nen percaktohet se edukatoret e kopshteve gezojne 32 dite leje te zakonshme, ndersa mesuesit 56 dite pune. Po keshtu, me kerkesen e SPASH-FSASH te zgjedhurve ne seksionet dhe keshillat sindikale u sigurohet leje e pagueshme per veprimet sindikale lokale, kombetare e nderkombetare, por kjo kerkese u duhet bere DAR ose ZA 5 dite para fillimit te aktivitetit. Pra ne kontraten kolektive eshte arritur qe drejtuesit te mos pengohen. Ndodh qe ka pengesa, por kjo vjen se drejtuesit sindikalist nuk luftojne per te zbatuar kete dispozite.

Per te vleresuar punen e mesuesit, e cila pasqyrohet me shperblimin ne nenin 8/4 thuhet qe, ne baze te nenit nr:1 te Ligjit Nr: 8487, date 13.05.1999, per kopetencat per caktimin e pagave te punes, punedhenesi eshte i detyruar qe, ne proçesin e hartimit te buxhetit te vitit, te konsultohet e te marre mendimin e sindikatave nenshkruese, para se propozimi te shkoje ne Qeveri. Ky konsultim ose dialog ne kryesite qendrore ka filluar te realizohet, por ne nivel qarku ose rrethi kjo pothuaj nuk ndodh. Vecanerisht kur eshte fjala per buxhetet lokale per arsimin, nuk ka transparence as bashkepunim me seksionet sindikale, gje qe u le shteg shperdorimeve dhe korrupsionit.

Kontrata permban edhe dispozita ne baze te te cilave Kryesite e Sindikatave Qendrore, me mbeshtetjen e MASH, do te bejne perpjekje per shtrirjen e shteses prej 2 perqind per vjetersi ne pune tek te gjithe mesuesit, per rritjen e shperblimit per kualifikim etj.

Ne Kontraten Kolektive te Punes eshte percaktuar sakte se sindikatat duhet te institucionalizojne anetaresine e tyre, e cila nuk mund te kuptohet pa u shoqeruar me pagesen e kuotizacionit. Aktualisht jo ne te gjithe keshillat sindikale anetaresimi ne sindikate shoqerohet me kuotizacion. Pengesat jane ne mosnjohjen e Kodit te Punes, te KKP nga drejtues te pushtetit lokal e qendror, problem qe ndoshta duhet zgjidhur edhe me ndonje akt nenligjor ne zbatim te Kodit te Punes. Me mire me kuotizacionin jane rrethet e Korçes, Gramshti, Lushnjes, Tiranes rreth dhe deri diku Dibra. Rrethet e tjera jane ne hapat e pare te zgjidhjes se ketij problemi, qe eshte mjaft shqetesues per SPASH .

Ne Kontraten Kolektive te Punes Sindikatat e Arsimit kane marre persiper detyrime konkrete per perfshirjen ne reformimin dhe modernizimin e arsimit, per eliminimin e punes se femijeve, etj. Sidomos per uljen e numrit te femijeve qe braktisin shkollen SPASH e FSASH, me mbeshtetjen e EI dhe te Sindikates Holandeze te Arsimit, AOb, bejne nje pune te panderprere, te kualifikuar dhe frutdhenese.

Tani qe KKP eshte nenshkruar nga 21 seksione sindikale ne nivelin e dyte dhe perpjekjet e sindikatave per t'i zbatuar kerkesat dhe dispoozitat e ketyre kontratave jane rritur, ne do te kemi mundesi per te pasuruar pervojen tone ne kete fushe kaq te rendesishme te institucionalizimit te sindikates.

Defrim Spahiu
N/Kryetar i SPASH

# SYNIMI YNË: RUAJTJA DHE ZHVILLIMI I TRADITAVE MË TË MIRA ARSIMORE TË POPULLIT TONË



Prof. as.Dr. MURAT GECAJ
sekretar i Shoqatës së Arsimtarëve të Shqipërisë

Afër 11 vjet më parë, më 6 qershor 1996, në Tiranë u krijua Shoqata e Arsimtarëve të Shqipërisë. Gjatë kësaj periudhe, me përkushtimin e Kryesisë, të veprimtarëve të shumtë te saj, janë organizuar e zhvilluar mjaft veprimtari të dobishme. Ndër të tjera, kanë qenë mbresëlënëse veprimtaritë e larmishme me rastin e festave të 7 Marsit dhe në kuadrin e festave të Nëntorit.

Veprimtari të tilla mbresëlënëse u organizuan në kryeqytet e në rrethe edhe sivjet, në fillim të muajit mars, me rastin e Ditës së Arsimit Kombëtar Shqiptar. Kështu, në veprimtarinë e zhvilluar në sallën kryesore të Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë, ndër të tjera, u lexuan këto referate: "Mësonjëtorja e Parë Shqipe" (nga Prof.dr. Shefik Osmani), "Objektet materiale, si pasuri dhe bazë argumenti për edukimin e brezave të rinj" (nga Prof.dr. Hektor Veshi) dhe "Ndaj shkollës kemi detyra të gjithë"(nga Viron Kona, shkrimtar e redaktor në Gazetën "Mësuesi"). E bukur ishte edhe veprimtaria e degës së arsimtarëve të rrethit Kukës, që kryesohet nga Mahmud Bulica.

Po kështu, me interes janë ndjekur veprimtaritë kushtuar figurave të shquara të arsimit tonë, që nga ata të Rilindjes Kombëtare, të Mësonjëtores së parë shqipe në Korçë dhe në rrethe të tjerë të vendit tonë. Gjithashtu, janë pëlqyer veprimtaritë kushtuar përurimit të botimeve të anëtarëve të kësaj Shoqate, nga fusha e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar etj. Meritojnë të nderohen dhe të përgëzohen të gjithë anëtarët e veprimtarët e kësaj Shoqate, të cilët kanë publikuar vitet e fundit libra me tematikë nga fusha të ndryshme të dijes, sidomos nga ajo e arsimit kombëtar shqiptar. Ndër ta janë: Prof. Bedri Dedja-Akademik, Prof. Hamit Beqja-Akademik, Prof.Dr. Shefik Osmani, Prof. Dr. Koli Xoxi, Prof. Dr. Ilinden Spasse, Prof. Dr. Hektor Veshi, Prof. as. Dr. Ilir Kanini, Dr. Ibrahim Gashi, Vjollca Spaho-gazetare e botuese, Viron Kona-publicist e shkrimtar, Sherif Delvina-shkrimtar, Isa Halili-studiues e të tjerë.

Qëllimi kryesor i veprimtarive të Shoqatës së Arsimtarëve të Shqipërisë ka qenë dhe është ruajtja e traditave dhe e vlerave më të

mira arsimore të popullit tonë, në përpjekjet e parreshtura për edukimin e gjithanshëm të brezit të ri dhe për ngritjen e nivelit të procesit mësimor në shkolla. Përmes projekteve dhe metodave të ndryshme të punës, në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe me shoqatat joqeveritare, janë bërë përpjekje që të zvogëlohen sa më shumë dukuritë negative në shkollë e jashtë saj, si: niveli i ulët i mësimdhënies, moszbatimi i rregullores së shkollës, korrupsioni i disa arsimtarëve dhe braktisja e shkollës nga nxënësit, të cilët po e mbushin radhën e analfabetëve. Përmes referateve ose kumtesave, që janë lexuar në veprimtaritë e organizuara, janë venë në shënjestër edhe shfaqje të tjera të dëmshme në mjediset shkollore, si: pirja e duhanit, alkoolit e drogës, trafikimi i organeve njerëzore, krimi e dhuna në familje e në shkollë, prostitucioni etj.

Anëtarët e Shoqatës sonë, me anë të temave të përgatitura ose artikujve të botuar në shtyp, kanë trajtuar çështje të mprehta aktuale të procesit mësimor-edukativ, në shkolla e jashtë tyre. Ndër të tjera, është ngritur para organeve drejtuese të arsimit shqetësimi i mësuesve, nxënësve e prindërve për hartimin dhe botimin e teksteve mësimore sa më cilësore, me kërkesa të rrepta shkencore e metodike dhe me gjuhën letrare të njësuar. Këtij qëllimi i shërbeu edhe diskutimi i gjerë dhe hartimi i një rezolute për përmirësimin e Abetares, që ishte në përdorim një vit më parë. Po kështu, janë bërë sugjerime që të vlerësohet ende më tepër roli i psikologut në shkollë, duke e çmuar atë si një ndërlidhës të kualifikuar ndërmjet nxënësit, prindërve dhe mësuesve.

Frytshmëria e veprimtarive tona është shtuar ndjeshëm edhe nga një bashkëpunim me shoqata të tjera joqeveritare. Ndër to, përmendim Shoqatat "Tirana", "Miqtë e Gjuhës Shqipe",



"Bashkësia Dibrane" etj., dhe drejtuesit e tyre: Arben Tafaj, Tarik Llagami, Pandeli Çina, Mantho Nakuçi, Mesud Abule, Zef Ratkacori e të tjerë.

Ndihmesa e Shoqatës sonë në fushën e mësimit dhe edukimit të brezit të ri nuk do të mungojë edhe në të ardhmen, sidomos nëpërmjet veprimtarive sa më frytdhënëse dhe botimit të artikujve në gazetën "Mësuesi" e në media të tjera, nga anëtarët e specializuar të saj, në të gjithë vendin.

Një mundësi më e madhe për shtimin e numrit dhe cilësisë së veprimtarive tona është edhe bashkëpunimi ynë më i ngushtë me sindikatat e arsimit në qendër, në rrethe e në shkolla. Ne e ndiejmë se në këtë drejtim, së bashku, mund e duhet të bëjmë më shumë, sidomos në fushën e mbrojtjes së interesave të mësuesve tanë, në marëdhënie pune ose në pension qofshin ata. Mendojmë se edhe gazeta "Mësuesi" e revista "Tribuna Sindikale" lipset të pasqyrojne ne vazhdimesi veprimtarive e zhvilluara, ndersa vete mesuesit dhe drejtuesitt e shkollave duhet të shfrytëzojne më mirë kete shtyp te shkruar.

Është për t'u përmendur se, tashmë, Shoqata e Arsimtarëve të Shqipërisë ka krijuar një arkiv të pasur me filmime dhe albume fotografike, të cilat pasqyrojnë veprimtaritë e shumta, të zhvilluara gjatë jetës 11-vjeçare të saj, punë që do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

# Eshtë fjala për Mati Logorecin

1

"Pas pesëdhjetë vjetë përpjekjesh, vuajtjesh dhe gëzimesh të kushtueme arsimit kombëtar, më 7 Fruer të vitit 1941 ndërroi jetë veterani i shkollës shqiptare, Mati Logoreci..." Ky ishte njoftimi qe bënte revista 'Shkolla Shqiptare' në numërin e saj të 48-të të vitit 1941.

Ishte fjala për një apostull të fjalës shqipe, qe kurr nuk rreshti së punuari për shkollën kombëtare shqiptare nga Shkodra, në Prizëren, Shkup, Tiranë etj.

Në fjalën e lamtumirës, Ministri i atëhershëm i Arsimit, Profesor Ernest Koliqi, do të shprehte, në emër të kombit, ndjenjën e lartë të mirënjohjes së përjetëshme për këtë Mësues të Madh me keto fjale:

...Nuk kemi si t'i thurim kurorë lavdie më të madhe këtij të vdekuri të madh, se sa me e përshendet për në amshim me fjalën e gjuhës së ëmbël shqipe. Po, melodia e hyjnueshme e kësaj gjuhe e shoqëroi Mati Logorecin, sepse ky, me një veprimtari të parreshtur e me një dashuri idealistike të pashëmbullt, e lëvroi, e predikoi dhe e pasuroi duke zënë fill që atëhere, kur të xaninit e kësaj gjuhe ishte krim dhe marri; krim për armiqtë të cilët e shtypnin dhe e ndiqnin çdo përpjekje për lulëzimin e gjuhës me mënxyrat më të tmerrëshme; marri për atdhe-mohuesit, të cilët tue e përbuzun

Vijon në faqen 14

Vijon nga faqja 12

kujtojshin se nuk mund të ketë një gjuhë shqipe. E Mati Logoreci që pesëdhjetë vjet më parë, përmes këtyre pengesave dhe mundimeve martirizuese, tue pasur në mëndje dhe në zemër vetëm e vetëm përhapjen e arsimit kombëtar dhe lulëzimin dhe pasurimin sa më të madh të gjuhës shqipe, u bë një nga pionierët dhe veteranët ma të mëdhenj të shkollës shqiptare.

2

Po kush është ky martir, ky rilindas i përjetëshëm dhe misionar idealist i gjuhës dhe shkollës shqipe?

Cilat janë ato veti që e bëjnë atë të pavdekëshëm dhe cilat janë ato shtylla të ndritëshme mbi të cilat u ngrit jeta e tij?

Cila ishte në fakt shkolla e Logorecit?

…Lindi në vitin 1867 në Shkodër në familjen e tregtarit patriot shkodran, Frano Logoreci.

Siç shprehjet shtypi i kohës, në vitin 1887 ishte hapur në Shkodër shkolla tregëtare teknike e mbajtur prej etërve jezuit. Rreth kësaj shkolle u mblodh rinia e atij qyteti për të marrë mësimet në një program të caktuar mesimdhënie dhe pune.

Ashtu si i jati, Matia, në fillim do t'i përkushtohej tregëtisë. Kjo, jo vetëm për traditë familjare, por edhe për faktin se administrata e atëherëshme turke nuk e lejonte elementin jo mysliman që të merrte pjesë në administratë.

Dëshirë kishte që të hapte një bisnes më vehte, por i mungonin mjetet e duhura financiare. Atehere në Shkoder, përveç shumë bisneseve të rëndësishme, ishte edhe shtëpia e dëgjuar tregëtare Parruca. Kjo shtëpi, përveç bisnesit në qytetin e saj të lindjes, kishte edhe një fabrikë mëndafshi në Monfalcone të Italisë. Për faktin se Mati Logoreci, megjithëse në moshe të re, zotëronte mire italishten dhe kishte talent në administrim, kjo shtëpi tregëtare e punësoi Matin e ri si sekretar llogaritar në Monfalcone të Italisë, në atë punëtore mëndafshi.

Në këtë punë Matia do të fitonte përvojë në menaxhim bisnesi, një përvojë që do ta ndihmonte në të ardhmen në administrimin e shkollave. Nga ana tjetër ai do ta përdorte kohën e lirë për të studjuar. Duke u dashuruar me veprën e Mazzinit, ai u frymëzua që me anë të hapjes së shkollave të ngrinte lartë uraganin e lirisë.

Një nga veprat më të mëdha të Mati Logorecit është hapja, më 1 maj të vitit 1899, e shkollës se parë shqipe në Prizëren.

Me të drejtë studjuesi i apasionuar, Lefter Dilo, për këtë periudhë do të shkruante…

"…Logoreci në veri, Sotir Kolea në jug dhe Aleksandër Xhuvani në kërthizë të Shqipërisë, formojnë pararojën e luftëtarëve për zhvillimin e gjuhës. I pari, u shqua me tepër si nje polemist, kurdoherë gati, i cili me një hov të veçantë, shkroi pa u kursyer në çdo shtyllë gazete, në çdo të përkohëshme shqipe. Polemikat e tij do të mbeten të paharruara sepse në shkrimet e tij vihet re edhe sot sinqeriteti i fjalëve.

Pas Prizerenit, fushë veprimi e punës së paharruar misionare të Mati Logorecit do të bëhej qyteti i tij i lindjes, Shkodra, nje qytet që ai e kuptonte dhe e donte.

Në qoftë se në Korçë lindi shkolla shqipe, në Shkodër u rrit dhe u konsolidua. Në ato vite në këtë qytet avanpost të çështjes kombëtare shqiptare vepronin dy shoqata atdhetare kulurore arsimore, "Bashkimi" dhe "Agimi".

Shoqëria "Agimi" e çoi Mati Logorecin në Sofje të Bullgarisë për t'u marr vesh me Shahin Kolonjën për njësimin e alfabetit shqip dhe për t'i hapur rrugën Kongresit të Manastirit. Në këtë Kongres ishte delegat i Shkodrës, krahas Fishtës, Gurakuqit e Mjedës edhe Mati Logoreci.

Më tej, Mati Logoreci do të hapte në Shkodër edhe klubin "Gjuha Shqipe". Vite më pas Mati Logorecin do ta shikojmë në Tiranë ku do të drejtojë një shkollë. Edhe kur doli në pension, ai vazhdoi të punojeë si drejtor i konviktit privat Vaso Pasha, ndersa në vitin 1935 drejtoi gazetën "Drita".

3

Ndaj na duket me vënd që këtë shkrim ta mbyllim përsëri me fjalët e ish Ministrit të Arsimit, Profesor Ernest Koliqi në fjalën e lamtumirës.

"…Shkolla shqipe është krenare që ka patur në gjirin e saj një Mati Logoreci, sepse ky për një gjysëm shekulli përhapi bukurinë e gjuhës shqipe, u derdhi ne zemra shqiptarëve të vegjël dritën e flakët e atdhedashurisë dhe u mbolli në shtresat e ndërgjegjes farën jetëdhënëse të virtuteve të racës sonë.

Matisë gjithmonë fytyra i ka shkëlqyer me dritën e edukatorit më të lartë, zemra gjithmonë i ka rrahur me dashurinë e prindit më të zhuritur, mendja gjithmonë i ka menduar me kthjelltësinë e rinisë më të ndezur dhe pengesat gjithmonë i ka kapërxyer me guximin, me durimin dhe gjakftohtësinë e një heroi.

Mati Logoreci u nda prej gjirit tonë me shume se 50 vjet me pare, por kujtimi i tij lartësohet e shënjtërohet dhe gjithnje mbetet simbol i therorisë së gjithë atyre mësuesëve shqiptarë që punuan për lulëzimin e shkollës sonë, për ta bërë gjuhën shqipe që të përjetësohet në buzën e shqiptarit, porsi kënga në gojë të bilbilit.

E mbi këtë varr të simbolizuar, shkolla shqiptare, përmes zemrave të gjithë mësuesëve e nxënësve të vetë, i skalit fjalët më mirënjohëse…"Të falemi o mësues…"

4

…Pak përpara vdekjes ai ishte duke mbledhur fjalë të rralla shqipe në një ambjent me të ardhur nga larg. Defteri me fjalë të rralla shqipe ishte në xhepin etij.

…Mësues, sot të gjithë jemi nxënës
Dhe ti na vështron tej nga retë
Dhe kur mësimi të filloi të hënën
Dikush do na korigjojë përjetë..

Kështu shkruajti një poet ato ditë kur Mësuesi i Madh mbylli sytë.

Është fjala për Mati Logorecin..

Zenel Anxhaku

# Të reja shkencore

## ROBOTI SAUVIGNON

Ky robot i vogël, me një dorë me top, është në gjëndje të provojë verën duke



përdorur sensorë infra të kuq dhe një spectometër që ndodhet në krahun e tij. Duke futur dorën direkt në një shishe vere, le të themi Sauvignon të Bardhë, roboti mund të analizojë përbërjen kimike të lëngut që ndodhet brenda për të përcaktuar tipin, markën dhe shijen dhe, më pas, të sugjerojë llojin e djathit me të cilin duhet shoqëruar ajo, (të gjithë informacionin e nxjerr me zë të lartë).

## MAKINA QE KTHEN KASHTËN NË MATERIAL NDËRTIMI

Ndonjëherë, dikush nxjerr në treg një shpikje kaq të thjeshtë dhe të zgjuar, sa ngelemi të çuditur ku ka qenë gjithë këtë kohë. David R. Ward krijoi StrawJet, një pajisje që përpunon kashtën duke e kthyer në tulla që mund të përdoren si material për ndërtim. Pajisja e Wardit, në vend që të përdorë përbërje kimike të rrezikshme, përdor argjilë për të bërë të mundur lidhjen e përbërësve për të formuar tullën prej



kashte. Ward shpreson që kjo pajisje do të ndihmojë për të ndërtuar shtëpi të lira dhe në një kohë të shkurtër në vendet në nevojë.

## SI PELERINË

Llampa e trashë sa një letër e CeeLite mund të shkojë virtualisht gjithandej, rreth një jastëku e në dysheme. Kondensatorët që lëshojnë dritë (LEC)



janë kryesisht pjese plastike 1 mm të gjera. Brenda tyre ndodhet një shtresë fosfori që, kur ngjeshet me një rrymë tjetër, shkëlqen me një ngjyrë të bardhë të ndezur, ( jo blu si llampa të tjera). LEC ndriçon siperfaqet në mënyrë të barabartë, por mund të programohet edhe për t'u zbehur ose per t'u shndritur në kontakt me diçka.

# Keshilla praktike

## PESË GAFA TË SIKLETSHME NË PUNË

*Ne kemi patur të gjithë momente të këqija në punë, që shoqërohen me sikletin që ndjen kur kupton që sapo the ose bëre diçka që nuk mund ta tërheqësh dhe që e di që do të shkaktojë një reagim nga ana e palës tjetër.*

*Përpiqeni të mos dukeni më në zyrë për ca kohë, por koha shëron të gjitha plagët, edhe ato të shkaktuara nga turpërimi.*

*Mënyra si kjo situatë përballohet është një faktor bazë në vazhdimësinë e gjithçkaje në punë.*

*Ja ku janë disa disa sugjerime si të lësh gjithçka mbrapa:*

**1. Jeni duke bërë një prezantim dhe dalloni një fjalë të shkruar keqnë ekran që mund të shihet nga të gjithë.**

***Çfarë mund të bëni për të rregulluar gjithçka? Pranojeni.***

Këshillohet që sinqeriteti të jetë mënyra më e mirë për të përballuar këtë situatë. Pranojeni gabimin dhe mos u përpiqni të flisni shumë në lidhje me të se mund të përfundoni keq. Bëni ç'është e mundur për të korrigjuar gabimin tuaj dhe vazhdoni më tej.

**2. Jeni në një mbledhje me pronarin e kompanisë dhe drejtorë të tjerë të rëndësishëm. Të gjithëve aty rrotull u tërhiqet vëmendja nga zhurma që bën stomaku juaj i uritur.**

***Çfarë mund të bëni për të rregulluar gjithçka? Bëni pak humor.***

Asgjë nuk është më mirë në një moment të tillë, se një buzëqeshje e qetë për të ç'tensionuar situatën. Këshillohet që të thuhet diçka e tillë si: "Kam frikë se pas këtij takimi duhet të vrapoj drejt restorantit dhe të ha një drekë të bollshme"

**3. Ju donit t'u dërgonit miqëve tuaj e-mailet me përmbajtegazmore dhe paksa të turpshme, por nuk e kuptuat që edhe një ndër kolegët tuaj është shtuar aksidentalisht në listë.**

***Çfarë mund të bëni për të rregulluar gjithçka? Vëruani fajin të tjerëve.***

Teknikët e kompjuterave janë të parët që zakonisht fajësohen në të tilla raste. Megjithatë, çfarëdolloj gjëje që të ketë ndodhur është mirë që të kërkoni falje menjëherë. Mësoni që herë tjetër të kontrolloni mirë, para se të dërgoni e-maile të tilla.

**4. Shefi ju dëgjon që po e kritikoni ashpër në bisedë me një kolegndërsa jeni në restorant.**

***Çfarë mund të bëni për të rregulluar gjithçka? Kërkoni falje dhe filloni një bisedë.***

Pavarësisht se ajo që po thoni është e vërtetë apo jo, duhet të tërhiqeni dhe të kërkoni falje qe nuk ia keni thënë atij, por po e diskutoni këtë fakt me kolegë të tjerë. Ky mund të jetë një rast i mirë për të folur me të dhe për t'i treguar çfarë nuk shkon në marrëdhëniet tuaja.

**5. Sapo përfunduat një telefonatë konferencë, (me 2 ose më shumë persona), pasi e mbyllët me një prej tyre, filloni ta kritikoni dhe ta shani, vetëm se telefonata në fakt nuk është mbyllur asnjëherë dhe personi tjetër dëgjon gjithçka.**

***Çfarë mund të bëni? Përpiquni të rregulloni diçka.***

Po të keni pak fat, do të kuptoni që personi është akoma në linjë pa kaluar në kritika të rënda. Gjithçka mund të bëni është të qëndroni në ato që keni thënë, por t'i riformuloni duke përdorur ton dhe fjalë më pak të ashpra. Për shëmbull fjalinë "A s'tu duk ideja e saj gjëja më idiote që ke dëgjuar ndonjëherë", mund ta riformuloni:

"Ndoshta duhet ta rishqyrtojmë idenë e saj sepse nuk mendoj se do të funksionoje"

Përgatiti faqen Eriona Vangjeli

# Tribuna sindikale

